



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 04 Maj 2021

Nr: 338

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË
PËRGJITHSHME PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. ZEF KIN HILA, KANDIDAT
PËR DEPUTET I SUBJEKTIT POLITIK, PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË-
ALEANCA PËR NDRYSHIM, QARKU SHKODËR, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015
“PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN
OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të pikës 12 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 517/43 prot., datë 20.04.2021, me lëndë “Dërgohet vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues z. Zef Kin Hila, kandidat për deputet i subjektit politik, Partia Demokratike e Shqipërisë - Aleanca për Ndryshim, qarku Shkodër,

VËREJ:

I.

- a) Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për



Data: 04 Maj 2021

Nr. 338

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Zef Kin Hila, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Demokratike e Shqipërisë - Aleanca për Ndryshim, Qarku Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015

administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
- Kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. z. Zef Kin Hila, kandidat i listës shumëmemërore të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë- Aleanca për Ndryshim, Qarku Shkodër, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 2309 unik.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Zef Kin Hila, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

- i. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2190 prot., datë 17.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe me shkresën nr. 2213 prot., datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion zyra e gjendjes civile.
- ii. Me shkresën nr. 2850/1 prot., datë 17.03.2021, Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se kandidati për deputet z. Zef Kin Hila, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 77 prot., datë 07.03.2021, në bazë të vendimit nr. 474, datë 21.12.2007 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar të pafajshëm për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim Detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi nuk provohet se fakti ekziston.
- iii. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 79, datë 25.03.2008 ka vendosur lënien në fuqi.
- iv. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 1158/1 prot., datë 08.04.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se kandidati për deputet z. Zef Kin Hila, nuk ka ndryshime në gjenealitet.
- v. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Zef Kin Hila, përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, konstatoi se kandidati për deputet nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr.



138/2015. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë në momentin e miratimit të listës shumeemërore.

- vi. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 156, datë 17.03.2021, vendosi “Miratimin e listave shumemërore të Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PDPR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi për zonat Zgjedhore Qarku Berat për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 9, Qarku Dibër për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 6, Qarku Durrës për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 15, Qarku Elbasan për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 15, Qarku Fier për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 18, Qarku Gjirokastrë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 6, Qarku Korçë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12, Qarku Kukës për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në 3, Qarku Lezhë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 9, Qarku Shkodër për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12, Qarku Tiranë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në 36 dhe Qarku Vlorë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12.

II.

Referuar indicieve të bëra publike nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2441 prot., datë 22.03.2021, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për të kryer verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka kompetencën për të kryer verifikime, për sa i përket ndalimeve të parashikuara në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.138/2015, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Me shkresën nr. 517/43, datë 20.04.2021, protokolluar me tonën me nr. 2441/1 prot., datë 20.04.2021, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin e rezultatit të verifikimit për subjektin



vetëdeklarues, z. Zef Kin Hila, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë - Aleanca për Ndryshim, qarku Shkodër.

Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme “Për miratimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 për subjektin vetëdeklarues, z. Zef Kin Hila, kandidat për deputet i subjektit politik, Partia Demokratike e Shqipërisë - Aleanca për Ndryshim, qarku Shkodër”, rezulton se, Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar institucioneve si më poshtë, për verifikim të mëtejshëm:

- a. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 3191/1 prot., datë 25.03.2021, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme dokumentin “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11 prot., datë 25.03.2021. Nga ky dokument informohemi se shtetasi Zef Kin HILA, i datëlindjes 23.02.1961, me vendimin nr. 474, datë 21.12.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është deklaruar i pafajshëm për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.79, datë 25.03.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 474, datë 21.12.2007.
- b. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 1243/1 prot., datë 30.03.2021, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit Zef HILA, sipas Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave konstatohet se subjekti Zef Hila, me atësi Kin dhe amësi Marije, lindur në Barbullush, Shkodër në datë 23.02.1961, me numër personal G10223083B, figuron i regjistruar banor në zyrën e gjendjes civile, në Njësinë Administrative Bushat, Bashkia Vau i Dejës, konstatohet se nuk ka ndryshime në përbërsit e gjendjes civile.
- c. Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, rezulton se subjekti Zef Hila;
 - ka ato gjenealitete, të cilat i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe që janë konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 - në datë 22.09. 2016, janë referuar materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për shtetasin z. Zef Kin Hila, me detyrë kryetar i Bashkisë Vau i Dejës, për veprat penale “Shpërdorim detyrë” dhe “Falsifikim dokumentash” parashikuar nga nenet 248 dhe 186/1 të Kodit Penal.
 - nuk figuron si person i dëbuar nga territori i një shteti tjetër apo që të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar në ngarkim të tij;



- d. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale, me shkresën nr. 5945/2 prot., datë 31.03.2021, na informon se;
- nga të dhënat e grumbulluara në sistemin elektronik, subjekti **Zef Kin Hila**, lindur në datë 23.02.1961, nuk figuron i ndaluar /arrestuar nga strukturat e policisë së shtetit.
 - nuk ka të regjistruara gjenealitete të tjera, përveçse ka deklaruar;
 - nga verifikimi i kryer në arkivën elektronike të ZQK Interpol Tirana, ka rezultuar se për këtë shtetas nuk ka asnjë informacion dhe dokumentacionin përkatës për përfshirje në ndonjë aktivitet kriminal si dhe nuk është person në kërkim ndërkombëtar.
- e. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me shkresën nr. 2701/1 prot., datë 15.04.2021, ka vënë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin përkatës, sipas të cilave, pas verifikimeve të kryera, rezulton si më poshtë vijon:
- v. i Ka regjistruar procedimin penal nr. 368/2006, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky procedim është dërguar në gjykatë më datë 25.04.2007.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 474, datë 21.12.2007, ka vendosur “Deklarimin të pafajshëm të pandehurit Zef Kin HILA”, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi nuk provohet që fakti ekziston.
 - Kundër këtij vendimi, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka paraqitur ankim përpara Gjykatës së Apelit Shkodër.
 - Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 79, datë 25.03.2008, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. 474, datë 21.12.2007 të Gjykatës së Shkallës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, me këtë ndryshim: në vend të fjalës “pasi nuk provohet që fakti nuk ekziston” në pikat 1 dhe 2 të dispozitivit të vendimit, vendosen fjalët “fakti nuk përbën veprë penale”.
 - Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka paraqitur rekurs Prokuroria e Apelit Shkodër. Kjo e fundit, me vendimin nr.00-2010-1061 (718), datë 02.07.2010, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. 79, datë 25.03.2008, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me trup tjetër gjykues”.
 - Gjykata e Apelit Shkodër, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 79, datë 26.04.2012, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. 474, datë 21.12.2007, të

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, duke ndryshuar shkakun e pafajësisë nga “fakti nuk ekziston” në atë “fakti nuk përbën vepër penale”.

- Kundër këtij vendimi të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka paraqitur rekurs Prokuroria e Apelit Shkodër. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2014-874, të datës 19.06.2014, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokurori pranë Gjykatës së Apelit Shkodër”.
- v. ii Referuar materialeve të përcjella bashkëlidhur kthim-përgjigjes dhe kallëzimit penal të ardhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar fillimisht procedimin penal nr. 350, datë 28.06.2005 për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (pa emër). Me vendimin datë 01.07.2005, ky procedim është pushuar.
- v. iii Më datë 19.01.2010, është regjistruar procedimi penal nr. 53, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.
- Më datë 23.09.2009, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Shkodër ka regjistruar kallëzimin e shtetasit N.M.
 - Më datë 15.10.2009, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për këtë kallëzim penal.
 - Pas ankimit të kallëzuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 291, datë 14.12.2009, ka vendosur kthimin e çështjes për vazhdimin e hetimeve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
 - Me vendimin datë 20.12.2010, çështja penale nr. 53/2010, është pushuar.
- v. iv Ka regjistruar procedimin penal nr. 528, për veprat penale të “Kanosjes së shtetasit për deklaramë a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë” dhe “Dëmtimeve të tjera me dashje, të parashikuara nga nenet 312/a, 90 dhe 25 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasit Zef Hila. Me vendimin datë 22.11.2015, ky procedim është pushuar.
- v. v Kallëzimi penal i shtetasit Z.L. nr. 232, datë 23.02.2011, është regjistruar si procedim penal me nr. 259, për veprën penale të “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, i parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal. Me vendimin datë 20.04.2011, ky procedim është pushuar.
- v. vi Kallëzimi penal i shtetasit K.F. është regjistruar si procedim penal nr. 1137, datë 02.07.2016, për veprat penale të “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186/3 dhe 25, të Kodit Penal. Me vendimin datë 18.11.2006, ky procedim është pushuar.

- v. vii Mbi bazën e referimit të bërë nga Policia Gjyqësore e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër nr. 2307/2016, datë 22.09.2016, ku përmendet edhe emri i shtetasit Zef Hila, është regjistruar procedimi penal nr. 1708, për veprat penale të “Falsifikimit të dokumentave “, parashikuar nga neni 186/3 dhe 25, të Kodit Penal (pa emër). Kjo çështje është dërguar për gjykim për disa të pandehur por jo për shtetasin Zef Hila.
- v. viii Mbi bazën e kallëzimit të shtetasit B.SH.nr. 1664, datë 03.07.2015, ku përmendet edhe emri i shtetasit Zef Hila, është regjistruar procedimi penal nr. 1745/2015, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (pa emër).
- Mbi bazën e kallëzimit me nr. 1226 prot, datë 18.05.2015, është regjistruar edhe procedimi penal me nr. 242, datë 08.02.2016, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (pa emër).
 - Ky procedim i është bashkuar pas vendimit datë 18.02.2016, “Për bashkimin e procedimeve penale”, me procedimin nr. 1745/2015, duke u bërë një procedim i vetëm që mban nr. 1745/2015.
 - Me vendimin datë 28.09.2016, procedimi penal i bashkuar nr. 1745/2015, është pushuar.
- v.ix Për materialin kallëzues nr. 915, datë 17.04.2015, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me vendimin datë 28.09.2015, është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal”, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.
- Me vendimin nr. 36(1123), datë 29.03.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur: “Shfuqizimin e vendimit datë 28.09.2015, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe rifillimin e hetimeve”.
 - Me vendimin nr. 139, datë 18.07.2016, Gjykata e Apelit Shkodër, ka vendosur “Shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër datë 28.09.2015, “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me kallëzimin nr. 915, të vitit 2015, dhe kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme, për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.
 - Mbi bazën e këtij vendimi është regjistruar procedimi penal nr. 1313, datë 22.07.2016, për veprën penale të “Refuzimit për deklarimin, mosdeklarim, fshehje

ose deklarim të rremë të pasurive, interesave të personave të zgjedhur dhe nëpunsve publike ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal. (pa emër).

- Me vendimin datë 25.07.2017, proçedimi penal nr.1313/2016, është pushuar.
- Vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr. 192(5201), datë 11.12.2017, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit datë 25.07.2017, “Për pushimin e proçedimit penal nr. 1313/2016.” të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim kërkuesi në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin nr. 24, datë 24.01.2018, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. 192 (5201), datë 11.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

v. x Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi bazën e akteve të ardhura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 1558/2019, për veprat penale të “Falsifikimit të formularëve”, “Shpërdorimit të detyrës”, “Fshehje e të ardhurave”, parashikuar nga nenet 190; 248; dhe 180 të Kodit Penal.

- Më datë 06.01.2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vendosur Shpalljen e moskompetencës lëndore për hetimin të çështjes, dhe aktet ia ka kaluar në Prokurorinë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. (Sipas përgjigjes zyrtare të SPAK, kjo çështje vijon në hetim, pa emër personi të regjistruar).

v. xi Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar procedimin penal nr. 1549, datë 24.09.2018, për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë proçedim është kërkuar në gjykatë pushimi i proçedimit penal nga ana e prokurorit, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 891(2272), datë 07.05.2019, vendosi pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e proçedimit penal nr. 1549/2018, pasi fakti i kallëzuar nga shtetasi K.F, nuk parashikohet si vepër penale.

v. xii Mbi bazën e kallëzimit nr. 914/2015, datë 06.09.2018 të shtetasve N.M e S.M, për shtetasin Zef Hila, është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 21, datë 24.02.2016, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të prokurorit datë 01.10.2015, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve për këtë kallëzim.
- Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 107, datë 18.09.2017.
- Mbi bazën e këtyre vendimeve gjyqësore dhe kallëzimit të shtetasve N.M e S.M, është regjistruar procedimi penal nr. 1495/2017, për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
- Për këtë procedim në datë 08.04.2021, është kërkuar pushimi në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

v. xiii Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka rregjistruar procedimin penal nr. 111, të vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 248, 190, 180, 287 të Kodit Penal.

- Me vendim të datës 15 janar 2020, është shpallur moskompetenca lëndore dhe aktet e procedimit penal janë dërguar për ndjekje të mëtejshme pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në datë 15.01.2020. (Sipas përgjigjes zyrtare të SPAK, shënuar më poshtë, kjo çështje vijon në hetim, pa emër personi të regjistruar).

v. xiv Policia gjyqësore ka referuar veprat penale të “Dëmtimit me dashje të materialit zgjedhor”, “Shkatërrimi i pronës me zjarr” dhe “Kundërshtimi i punonjësve të rendit publik”, parashikuar nga nenet 236/a; 151/2 dhe 236/2 të Kodit Penal, mbi bazën e të cilës Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar si kallëzim penal nr. 1248/2019, ku ndër të tjera përmendet edhe emri i shtetasit Zef Hila.

- Ndaj këtij kallëzimi, me vendimin datë 15 korrik 2019, prokurori i çështjes ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

v. xv Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar procedimin penal nr. 545/2017, i cili është bashkuar me procedimin penal nr. 1481 të vitit 2017, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, (pa emër), çështje nën hetim.

v. xvi Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar procedimin penal nr. 282/2019, të regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (pa

emër), çështje nën hetim. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar proçedimin penal nr. 1805/2019, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (pa emër), çështje nën hetim.

v. xvii Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar proçedimin penal nr. 1805/2019, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, (pa emër), çështje nën hetim.

v. xviii Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar proçedimin penal nr.1193/2015, për veprat penale të “Falsifikimi i dokumentave”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, (pa emër).

- Me vendimin datë 06.10.2015, ky proçedim është pushuar.

v. xix Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar proçedimin penal nr. 1927/2018, për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (pa emër). Me kërkesën e datës 14.11.2018, i është kërkuar Gjykatës pushimi i këtij proçedimi.

- Gjykata e rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1316, datë 04.07.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, për pushimin e proçedimit penal nr. 1927, të vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi nuk provohet që personi nën hetim, Zef Hila të ketë kryer veprën penale për të cilën është dyshuar.

- Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

f. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, me shkresën nr. 340/1 prot., datë 29.03.2021, lidhur me subjektin Zef Hila, ka vënë në dispozicion kopje të njësuar me origjinalin të:

vi. Vendimit nr. 79, datë 25.03.2008 dhe nr. 79, datë 26.04.2012, të kësaj gjykate.

- Referuar vendimit nr. 79, datë 25.03.2008, rezulton se kjo gjykatë, ka marrë në shqyrtim ankimin ndaj vendimit nr. 474, datë 12.12.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku i pandehuri Zef Kin HILA është deklaruar i pafajshëm për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi nuk provohet se fakti ekziston.

- Në përfundim të gjykimit, është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 474, datë 21.12.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me ndryshimin që në vend të

fjalëve “Pasi nuk provohet që fakti nuk egziston”, të vendosen fjalët “fakti nuk përbën veprë penale”.

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 718, datë 02.07.2010, ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. 79, datë 25.03.2008 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.
- Gjykata e Apelit Shkodër, pas rigjykimit, me vendimin nr. 79, datë 26.04.2012, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 474, datë 21.12.2007”, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me ndryshimin që në vend të fjalëve “pasi nuk provohet që fakti nuk egziston”, të vendosen fjalët “fakti nuk përbën veprë penale”.

vi. ii Vendimit nr. 254, datë 15.11.2017 të Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 7 datë 18.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila kishte vendosur; rrëzimin e kërkesës së shtetasve N.M dhe S.M, që kishin kërkuar kundërshtimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. 1193/2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i regjistruar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”.

vi. iii Vendimit nr. 24, datë 24.01.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 192, datë 11.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila kishte vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetasve N.M dhe S.M, kundër vendimit për pushimin e procedimit penal nr. 1313/2016 të Prokurorisë së Rrethit Shkodër, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.

vi. iv Vendimit nr. 278, datë 24.06.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 1316, datë 04.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila kishte vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit të Shkallës së Parë Shkodër, për pushimin e procedimit penal nr. 1927, të vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi nuk provohet që personi nën hetim, Zef Hila, të ketë kryer veprën penale për të cilën është dyshuar.

vi. v Vendimit nr. 5, datë 09.01.2020 të Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 1596, datë 24.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër e cila kish vendosur, mospranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për pushimin e procedimit penal nr. 545, të vitit 2017, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për personin nën hetim Zef Kin Hila, dhe vijimin e hetimeve për një afat 3 (tre) mujor.

- g.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. 339 prot., datë 29.03.2021, pas verifikimeve të kryera, ka vënë në dispozicion kopje të njësuar me origjinalin të:
- vii. i** Vendimit nr. 474, datë 21.12.2007, referuar vendimit, rezulton se kjo gjykatë ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin Zef Kin HILA, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi nuk provohet se fakti ekziston.
- Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
 - Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 79, datë 25.03.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 474, datë 21.12.2007 të Gjykatës së Rrethit Shkodër me këtë ndryshim: Në vend të fjalës “pasi nuk provohet se fakti ekziston”, të vendosen fjalët “fakti nuk përbën vepër penale”.
 - Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 718, datë 02.07.2010, ka vendosur; Prishjen e vendimit nr. 79, datë 25.03.2008 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.
 - Gjykata e Apelit Shkodër, pas rigjykimit, me vendimin nr. 79, datë 26.04.2012, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 474, datë 21.12.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me ndryshimin që, në vend të fjalëve “pasi nuk provohet që fakti nuk ekziston”, të vendosen fjalët “fakti nuk përbën vepër penale”.
- h.** Gjykata e Apelit Shkodër me shkresën nr. 512/1 prot., datë 25.03.2021, ka vënë në dispozicion vendimet penale nr. 79, datë 25.03.2008, nr. 79, datë 26.04.2012, nr. 254, datë 15.11.2017, nr. 24, datë 24.01.2018, nr. 250, datë 24.06.2019, nr. 278, datë 14.10.2019, nr. 5 datë 09.01.2020, (Vendime të sipërcituara në pikën VI & VII)
- i.** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, me shkresën nr. 3131/9 prot., datë 30.03.2021, na informon se në emër të këtij shtetasi, kjo zyrë prokurorie, mbi bazën e materialeve të përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 745, datë 27.07.2018, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
- ix. i** Me vendimin e datës 05.11.2018, është vendosur ndarja e procedimit nr. 745/2018 në procedimin penal nr. 745/1 datë 05.11.2018, për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 248, 190, 180, e 287 të Kodit Penal, ndaj të kallëzuarve Zef Hila, E.H dhe familjarëve të tyre.

- ix. ii Në datë 05.11.2018, është marrë vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. (Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, pas ardhjes së këtij materiali, nga kryqëzimi i të dhënave prej akteve e dërguara në funksion të procesit të dekriminalizimit, rezulton se ka rregjistruar procedimin nr. 111/2019, procedim i cili e më pas me vendimin e moskompetencës e ka përcjellë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), e sqaruar më poshtë).
- j.** Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), me shkresën nr. 2628/1 prot., datë 02.04.2021, na informon se;
- x. i Ky shtetas përmendet si i kallëzuar në kuadrin e procedimit penal nr. 107/2020, të regjistruar nga ish –Prokuroria Për Krime të Rënda Tiranë, në zbatim të vendimit nr. 208, datë 08.11.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit.
- x. ii Procedimi penal nr. 10/2020 është bashkuar me procedimin penal nr. 10/2020, të regjistruar nga ish-Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, (pas ardhjes për kompetencë të procedimit penal nr. 111/2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër), dhe procedimin penal nr. 91 (i regjistruar pas ardhjes për kompetencë të procedimit penal nr. 1558/2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër), në një procedim penal të vetëm nr. 91, të vitit 2020. Ky procedim është në fazën e hetimit dhe nuk ka emër të regjistruar.
- x. iii Është përmendur gjatë kryerjes së hetimeve që ka kryer ish-Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, në kuadër të procedimit penal nr. 199/2019, për të cilin ajo ka vendosur në datë 20.09.2019, dërgimin e akteve për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. (Kjo e fundit ka rregjistruar procedimin penal nr. 1558/2019, të cilën më pas e ka ridërguar për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar).
- x. iv Është regjistruar kallëzimi penal nr. 230, viti 2018, i cili më datë 04.01.2019, është vlerësuar të dërgohet për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Shkodër. Kjo e fundit, ka regjistruar procedimin penal nr. 282/2019, procedim i cili vijon të jetë nën hetim).
- k.** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. 3842/1 prot., datë 31.03.2021, na informon se nga verifikimi i kryer, kjo zyrë prokurorie ka regjistruar kallëzimin penal nr. 14292/2017, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit

rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit penal, më datë 12.01.2018. Bashkëlidhur kanë vënë në dispozicion kopje të vendimit të mosfillimit të kallëzimit penal.

- I. Nga informacioni i përcjellë nga Prokuroritë e tjera pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, Gjykatave të Apelit dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, rezulton se ndaj subjektit **Zef Kin Hila**, nuk janë regjistruar procedime penale, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi dhe nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

III.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se:

- Subjekti vetëdeklarues z. Zef Kin Hila, i është përgjigjur me “Jo” të gjitha pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit.
- Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 517/43, datë 20.04.2021, protokolluar me tonën me nr. 2441/1 prot., datë 20.04.2021, ka njoftuar rezultatet e verifikimit të thelluar të kandidatit për deputet të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë-Aleanca për Ndryshim (PD-AN), qarku Shkodër, z. Zef Kin Hila.
- Nuk rezultoi të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të ndryshme nga ato të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit;
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale, nga autoritetet gjyqësore shqiptare;
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar, për një çështje të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezultoi të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezultoi të ketë qenë i siguruar me ndonjë masë shtrënguese të sigurisë personale.
- Dhe pse në vendimin “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Zef Kin Hila”, të Prokurorisë së Përgjithshme referohen vepra penale të cilat përfshihen në fushën e ndalimit të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen,

emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nga verifikimet e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se kandidati për deputet z. Zef Kin Hila, nuk është dënuar për asnjërën prej tyre.

- Duke qenë se Prokuroria e Përgjithshme, në rezultatin e hetimit të thelluar nga ana e saj, pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda vendit, duke i konsideruar këto verifikime të plota bazuar në përcaktimet e nenit 8, pikat 1 dhe 2 të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, si dhe në përcaktimet e pikës 3, shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Kreut V të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, referon se z. Zef Kin Hila nuk është deklaruar fajtor për veprat penale të sipërcituara dhe nuk ka indicie apo të dhëna që do të justifikonin një verifikim për jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Për sa më sipër, referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe konkluzioneve të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, për subjektin deklarues z. Zef Kin Hila, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë – Aleanca për Ndryshim (PD-AN), qarku Shkodër, nuk ka të dhëna që subjekti përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në pikën 12 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,



V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Zef Kin Hila, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë – Aleanca për Ndryshim (PD-AN), Qarku Shkodër, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 04 Maj 2021

Nr. 338

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Zef Kin Hila, kandidat për deputet i subjektit politik, partia Demokratike e Shqipërisë - Aleanca për Ndryshim, Qarku Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015